

Nr. 128/1 - prot
Dt. 24.05.2012



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Ofrimit të Sherbimeve
Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. 4108/ Prot.

Tiranë, më 22. 5. 2012

Drejtuar : SH.A "TRAJTIMI I STUDENTEVE NR.3"

TIRANE

Lënda : Miratohet statuti i shoqërisë "Trajtimi i Studenteve Nr. 3" Tirane.

Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria "Trajtimi i Studenteve Nr. 3" Tirane, dërguar me tuaj shkresën nr.128 date 24.04.2012, konstatojmë se ai është hartuar në zbatim të dispozitave të nenit 230 të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Për këto arsye bazuar në Ligjin Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 " Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, nenin 216 e në vijim të Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", aksionari shtet i cili zotëron 100% të aksioneve të Sh.a "Trajtimi i Studenteve Nr. 3" Tirane, miraton statutin e ri të shoqërisë.

Ngarkohet "Trajtimi i Studenteve Nr. 3" Tirane, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" Seksioni III, Regjistrimi fillestar, neni 32,36.

Verifikohet Njësia me
originalin



MINISTRI
NASIP NAÇO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shoqëria e "TRAJTIMI I STUDENTËVE Nr.3, SH.A." TIRANE

Nr. 162 prot

Tirane me dt 25.05.2012

Lenda : **Kerkese per rregjistrimin e ndryshimeve te organeve Drejtuese dhe te Statutit te Shoqerise se Trajtimit te Studentave Nr 3 sha Tirane ne QKR.**

Drejtuar: Qendres Kombetare te Rregjistrimit Tirane

Bazuar në ligjin Nr. 9723, dt 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit", kerkojme nga ana juaj te kryeni veprimet perkatese per rregjistrimin e ndryshimeve te organeve drejtuese dhe Statutin e Shoqerise se Trajtimit te Studentave Nr 3 sha Tirane sipas te dhenave te meposhtme:

Emertimi, selia dhe adresa elektronike

Shoqëria anonime krijohet nga transformimi i ndërmarrjes shtetërore "Trajtimi I studenteve nr.3." Tirane me vendim të Gjykatës me nr 33707 dt 23.06.2005. Emertimi i Shoqërisë është "Trajtimi I studenteve nr.3.sh.a." Tirane. Selia e shoqërisë është në adresë **Adresa: Godina Nr. 6, Universiteti Bujqësor i Tiranës Telefon 047/200621** *Nj. Bashkiake Nr 11. Tirane*
Adresa e e-mail per qellim komunikimi elektronik te shoqerise eshte ndermarrja trajtim studenti nr 3@hotmail.com

Objekti i Shoqerise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: **Trajtimi i studenteve te Universitetit Bujqësor Tiranës ne konvikte.** Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj

Kohezgjatja.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa percaktim.

STATUTI

I

SHOQËRISË ANONIME

“TRAJTIMI I STUDENTEVE NR. 3” TIRANE

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr 9901, dt. 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa e faqes së internetit

Neni 1: Data e Themelimit, Emërtimi

Shoqëria anonime u krijua me vendim Nr.33 707, dt. 23.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Emërtimi i shoqërisë është: Sh.A “Trajtimi i Studenteve Nr. 3” Tirane.

Kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj me NIPT k517260220

Neni 2: Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Trajtimi i Studenteve të Universitetit Bujqësor të Tiranës në konvikt. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4: Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa elektronike

- Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Godina nr.6, Universiteti Bujqësor i Tiranës Tel.047/200621
- Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: www.ndermarrja_trajtim_studenti_nr_3@hotmail.com.



Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5: Vlera e kapitalit të regjistruar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 217 700 000 Leke i ndare ne 217 700 aksione me vlere nominale 1000 Leke secili. Aksioneri themelues: Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.

Kreu III

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- **Asambleja e Përgjithshme**
- **Administratori**
- **Këshilli Mbikëqyrës**

Neni 6 : Emërtimi i Administratorëve

Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë për një periudhë trevjeçare, në pajtim me pikën 2 të nenit 135, pikën 2 të nenit 167 dhe nenit 158 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi me shumicë të zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë administratorët nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.

Anëtarët e këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohen si Administratorë. Kufizime të tjera lidhur me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 158 të Ligjit.

Personat e mëposhtëm caktohen si administratorët e parë të Shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë të Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

- Sokol Delia
Tiranë.

Administratori

do të caktohet si Kryetar i mbledhjeve të
Administratorëve

Neni 7: Kompetencat e Administratorëve

- (1) Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorët të cilët mund të ushtrjnë të gjitha



kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e pikës 2 të nenit 167, shkronja "a", "gj", "h", dhe "i" të pikës 1 të nenit 154 dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 158 të Ligjit. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 167 dhe shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" të pikës 1 të nenit 154 të ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratorëve.

- (2) Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 8: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve

(1) Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 9: Kufizimet në Votimet e Administratorëve

(1) Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e këshillit Mbikëqyrës, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

1. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
2. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Zbatohet parashikimi i pikës 2 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit.

(2) Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.

(3) Në rast se në mbledhjen e Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtar të tij, çështja mund të drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 10: Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët; dhe



2. të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve të aksioneve të klasave të ndryshme ose mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës në të cilat kanë marrë pjesë Administratorëve të pranishëm në këtë mbledhje.

Neni 11: Këshilli Mbikëqyrës, emërtimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron të paktën tre ose më shumë persona fizikë, gjithmonë në një numër tek jo më të madh se 21, në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në përputhje me shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135, pikës 4 të nenit 167 dhe pikës 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërtimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës. Anëtarët e këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e përgjithshme, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.
- (2) Nuk mund të zgjidhen në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, Administratorët e Shoqërisë dhe të shoqërive të të njëjtit grup apo personat e lidhur me ta në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 13 të ligjit. Kufizimet e tjera për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës parashikohen në nenin 156 të Ligjit.
- (3) Shumica e anëtarëve të këshillit Mbikëqyrës duhet të jenë të pavarur sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.
- (4) Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një person i cili dëshiron të ushtrojë detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës për të plotësuar një vend të lirë ose si një anëtar tjetër shtesë, me kusht që të mos tejkalohej numri i anëtarëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Kohëzgjatja në detyrë e anëtarit të emëruar në këtë mënyrë është deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga:

- | | |
|-------------------|-----------|
| (a) Agim Bregasi | (Kryetar) |
| (b) Dhora Çadra | (Anëtar) |
| (c) Sonila Metohu | (Anëtar) |



Neni 12: Kompetencat e këshillit Mbikëqyrës dhe të Komiteteve së tij

- (1) Këshilli Mbikëqyrës nuk merr pjesë në administrimin e Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët dhe kontrollon pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit dhe të Statutit. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronjat "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" të pikës 1 dhe pika 2 e nenit 154 të Ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratorëve.
- (2) Këshilli Mbikëqyrës mund t'ia delegojë kompetencat e veta një komiteti që përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Ky delegim mund të bëhet në përputhje me kushtet që mund të vendosen nga Këshilli Mbikëqyrës e mund të revokohet ose të ndryshohet. Këshilli Mbikëqyrës nuk

mund të delegojë asnjë nga detyrat të cilat i ngarkohen në pajtim me dispozitat ligjore.

(3) Në përputhje me sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës krijon

1. një komitet i cili përcakton standardet për emërimin e administratorëve nga Asambleja e përgjithshme;
2. një komitet i cili përcakton skemën e shpërblimit dhe shpërblimin individual të Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
3. një komitet për kontrollin e mbarëvajtjes dhe kontabilitetit të shoqërisë.

Komitetet përbëhen nga një ose më shumë anëtarë të këshillit Mbikëqyrës shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur.

(4) Komitetet e emërimit, shpërblimit dhe të kontrollit japin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve që duhen marrë nga Këshilli Mbikëqyrës. Qëllimi kryesor i komiteteve është rritja e efikasitetit të Këshillit Mbikëqyrës duke u kujdesur që vendimet të merren në mënyrën e duhur si edhe të ndihmojnë organizimin e punës me synim sigurimin e vendimmarrjes që nuk përbën konflikt të interesave materiale. Krijimi i komiteteve nuk zhvendos çështjet e marra në shqyrtim nga Këshilli Mbikëqyrës i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet e marra në fushën e tij të kompetencës.

(5) Në veçanti, komiteti i kontrollit financiar;

1. mbikëqyr procesin e raportimit financiar;
2. mbikëqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të administrimit të rreziqeve;
3. mbikëqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe të konsoliduara, sipas Statutit;
4. shqyrton dhe mbikëqyr pavarësinë e ekspertëve kontabël të autorizuar ose të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar dhe, në veçanti, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e kontrolluar.

(6) Bazuar në vendimet e komisioneve të tij, Këshilli Mbikëqyrës:

1. i paraqet propozime Asamblesë së përgjithshme në lidhje me emërimin e Administratorëve dhe Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
2. harton raportin mbi ecurinë e veprimtarisë sipas shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 154 të Ligjit dhe ia dorëzon atë asamblesë së Përgjithshme sipas pikës 3 të nenit 137 të Ligjit;
3. harton raportin vjetor për drejtimin e brendshëm të shoqërisë dhe kualifikimin e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe e bën publik atë sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 134 të Ligjit.

(7) Asnjë ndryshim i Statutit dhe udhëzim i Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Këshillit Mbikëqyrës të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishte dhënë udhëzimi.

Neni 13: Skualifikimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

(1) Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:

1. personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157.
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;

4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 14: Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Mbledhjet e këshillit Mbikëqyrës do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa asambleja e përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshtësinë e këtyre mbledhjeve.
- (2) Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 167 dhe nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtar në momentin e emërimit.
- (3) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes.
- (4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- (5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, pavarësisht nëse bëhet e ditur në vijim se emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllë sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
- (6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikëqyrës është njësoj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit të Këshillit Mbikëqyrës, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

Neni 15: Kufizime për votimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk do të lidhin marrëveshje ose të votojnë në mbledhjen e këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit së Këshillit Mbikëqyrës mbi çështje për të cilat këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, ose që mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

1. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
2. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Zbatohet parashikimi i pikave 2 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit.

(2) Vota e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk gëzon të drejtën e votës.

(3) Në rast se në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtarit të tij, çështja mund të drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar.

Neni 16: Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:

1. të gjithë takimeve të Këshillit Mbikëqyrës; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrat e administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje.

Neni 17: Shpërblimi i punës dhe shpenzimet e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga këshilli mbikëqyrës dhe të miratuar me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 160 të Ligjit.
- (2) Përfitimet individuale përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Ato duhet të pasqyrojnë në mënyrë të përshtatshme detyrat e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me skemën e përmendur në pikën 1 të këtij neni të statutit dhe gjendjen financiare të Shoqërisë.
- (3) Me miratimin e asamblesë së përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës mund të shpërndajë shpërblime në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata Administratorë ose anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë pasur detyra dhe kanë punuar më parë për Shoqërinë ose kanë pasur detyra në organe të saj, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish – bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe Këshilli Mbikëqyrës mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.
- (4) Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, hotelit dhe shpenzime të tjera në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 18: Hetimet e posaçme dhe mbikëqyrja



Çdo person ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një eksperti të posaçëm në bazë të nenit 150 të Ligjit ose për të kërkuar nga këshilli Mbikëqyrës që të kryejë detyrat e tij në rastet e veçanta të parashikuara nga pika 2 e nenit 166, dhe neni 165 i Ligjit, depozitojnë në selinë e shoqërisë dokumentin e noterizuar i cili vërteton se ky/këta persona plotësojnë kushtet për të kryer këtë veprim.

Kreu IV

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 19: Dividendët

(1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhen dividendi; në rast se aksioni emërohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 20: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Kreu V

Prishja dhe njoftimet

Neni 21: Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën

e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

Neni 22: Njoftimet

- (1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në pikën 3 të nenit 4 të këtij Statuti janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- (2) Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke e dërguar me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit ose në adresën apo postën elektronike e cila i është njoftuar Shoqërisë nga aksionari. Kur ka disa bashkëzotërues të një aksionari, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët.
- (3) Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga Shoqëria do të publikohen nga Administratorët në faqen e internetit të Shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit të këtij Statuti.

Neni 23: Emerimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar

Eksperte Kontabel te Autorizuar, te emëruar nga asambleja e aksionereve (METE), janë:
Vera LALA
Vullnetare ÇELA

Neni 24: Asambleja e Përgjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblesë se përgjithshme te parashikuara nga Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare", qe nuk janë parashikuar ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.

Neni 25: Dispozita e fundit

Per çfarë nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqëritë tregtare.

Aksionari themelues
Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës

NASIP NAÇO

